



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë 20.02.2025

PROCESVERBAL

Konsultim Publik për Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës

Takimi filloi në ora 10:00

Grupi punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës u mbledh me datë 20.02.2025 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për të ofruar edhe mundësinë fizike të diskutimit të propozimeve për këtë Projekt Rregullore.

Në takim morën pjesë të gjithë anëtarët e grupit punues, përveç anëtarit Florent Koci.

Në konsultim ishin 34 (tridhjetekatër) pjesëmarrës të cilët patën mundësi të jepnin propozimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me rregulloren.

Konsultimin e hapi kryesuesi i grupit punues z. Kushtrim Brahimaj.

Z. Shkelzen Cermjani propozoi që struktura e Sektorit për Tatimin në Pronë të ristrukturohet ndryshe dhe me nivel të mesëm drejtues siç ishte planifikuar dikur.

Z. Shqipërim Hyseni propozoi që Sektori për Hapësira Publike të riemërohet Sektori për Hapësira Publike dhe Energjetikë.

Z. Dritan Nuqi propozoi që pozicioni i tij të avancohet nga profesional 2 në profesional 1.

Z. Fatos Deda propozoi dhe kërkoi që të ri dizajnohen detyrat e punës në Sektorin për Mbrojtje të Mjedisit dhe Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave sepse ka konflikt në detyrat e njëra tjetrës.

Z. Rozafat Hoxha propozoi ndarjen e detyrave në mes të Sektorit për Urbanizëm dhe Sektorit për Planifikim.

Z. Musë Gjergjaj propozoi disa ndryshime të shprehjeve apo fjalëve në detyrat e Sektorit për Gjendje Civile.

Z. Selman Sahiti propozoi që zyrtarët e Sektorit të Tatimit në Pronë të ngritën në pagë nga profesional 3 në profesional 1.

Në fund kryesuesi i grupit punues z. Kushtrim Brahimaj sqaroi të pranishmit se të gjitha propozimet e tyre do të shqyrtohen në takimin e radhës të grupit punues dhe vendimi do të merret në përputhje me arsyeshmërinë e propozimeve dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Takimi përfundoi në ora 10:45

Procesmbajtësi: Artan Hoxha